



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.227/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, , me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi në kontestin tregtar administrativ të paditësit “M...” ShPK me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “...” SHPK me seli Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli, vlerë kontesti 25,262.67€, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur në prani të përfaqësueses së autorizuar të paditësit, G.B nga Shoqëria e Avokatëve “...” dhe në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur, me datë 24.10.2022 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “M...” ShPK me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “...” SHPK me seli në Prishtinë
- II. ANULOHET aktvendimi me nr.06.2/237 i datës 03.12.2020 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “M...” ShPK me seli në Prishtinë, t’ia kthej shumën prej 25,262.67€ (njëzet/e/pesë/mijë/e/dyqind/e/gjashtëdhjetë/e/dy/euro/e/gjashtëdhjetë/e/shtatë/cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. R-6474/25.03.2014, R-

6781/29.03.2017, R-7257/04.04.2017, R-7827/11.04.2017, R-7828/11.04.2017, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Interevropa.

IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “M...” ShPK me seli në Prishtinë, përmes përfaqësuesit të autorizuar me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 19.01.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të dispozitave materiale dhe shkeljeve të dispozitave procedurale. Në seancën e shqyrtimit kryesor përfaqësuesja e autorizuar e paditësit deklaron se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe pranë të gjitha pretendimeve të cekura në padi. E paditura aktvendimin e kontestuar e ka lëshuar pas pranimi të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë A.nr.1025/2017 të datës 18.06.2020, me të cilin gjykata e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe lëndën e la kthyer përsëri në rishqyrtim dhe rivendosje pranë të paditurës. Sipas këtij aktgjykimi e paditura do të duhej të vlerësonte pretendimet e paditësit si dhe dokumentacionin përcjellës të mallit, mirëpo e paditura nuk ka vepruar konform rekomandimeve të gjykatës dhe përsëri e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve kontestuese, me arsyetimin e përsëritur se paditësi nuk ka prezantuar dokumente të mjaftueshme, dhe se vlerat e deklaruara nga paditësi nuk janë vlera reale, por janë deklaruar vlera më të vogla. Në lidhje me këtë konflikt administrativ është kërkuar mendimi profesional sipas ekspertizës financiare të cilën e kemi pranuar pa vërejtje, pasi që konsiderojmë se kjo ekspertizë i ka dhënë përgjigje kërkesave sipas aktvendimit të gjykatës për kryerjen e ekspertizës financiare. I propozojmë kësaj gjykate që të aprovojë si të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, dhe të anulohet aktvendimin e kontestuar, dhe të obligohet e paditura që paditësit t’ia kthejë shumën prej 25,262.67 €, të paguara më tepër nga paditësi në emër të detyrimeve doganore për DUD-at kontestues. Përfaqësuesja e autorizuar e palës paditëse në fjalën përfundimtare të deklaron se propozon kësaj gjykate që të aprovojë si të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, dhe të anulohet aktvendimin e kontestuar, dhe të obligohet e paditura që paditësit t’ia kthejë shumën prej 25,262.67 €, të paguara më tepër

nga paditësi në emër të detyrimeve doganore për DUD-at kontestues. Shpenzimet e procedurën nuk i kërkon,

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 26.10.2021 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuara. Me aktvendimin nr.06.2/327 të Doganës së Kosovës është refuzuar ankesa e paditësit si e pabazuar. Aktvendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron fare me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka arsyetuar as edhe me një provë të vetme relevante juridike. Tutje e paditura i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, duke lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës. Me parashtresën e datës 18.10.2022 e paditura Dogana e Kosovës është deklaruar lidhur më ekspertizën financiare duke deklaruar se vetëm diferencën nuk e kundërshton, e cila vlerë për DUD-at kontestues nga ana e të paditurës diferenca e pagesave është e saktë, shënime këto të siguruara nga sektori i vlerës të gjeneruara nga sistemi. Ndërsa pjesën tjetër të ekspertizës e kundërshton, konkretisht konstatimet e ekspertës lidhur me transferet dhe dokumentet tjera nuk ka arrit t'i harmonizoj ato në tërësi, por vetëm ka bërë përshkrimin e vlerave pa iu referuar numrave të faturave se për cilat pagesa janë realizuar ato dhe si të tilla e paditura i kundërshton në tërësi.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 24.10.2022, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimet 237/03.12.2022, 237/04.05.2017, Transaksionet Bankare Ndërkombëtare të realizuara në Bankën TEB të datës 03.05.2017, 10.07.2017, 09.08.2017, DUD-at kontestues 6474/25.03.2017, 6781/29.03.2017, 7257/04.04.2017, 7827/11.04.2017, 7828/11.04.2017, DUD-at jokontestues 4872/08.03.2017, 5520/15.03.2017, 4960/09.03.2017, 6168/22032017, 8515/19.04.2017, 9174/26.04.2017, Faturat e DUD-ave kontestues 2017-02/25.02.2017, ...00375/21.03.2017, ...00382/03.04.2017, 2017-03/07.03.2017, ...00384/10.04.2017, Faturat e DUD-ave jokontestues 2017-01/02.02.2017,

...00372/14.03.2017, ...00371/08.03.2017, ...00374/21.03.2017, ...00385/18.04.2017, ...00387/24.04.2017, përgjigja në padi e datës 26.10.2021, Kontratat e datës 25.07.2013, Lexohen Proceset mbi Përcaktimin e Vlerës së Mallrave për DUD-at 6781, 7257, 6474,7828, Deklaratat EXA, Ekspertiza Financiare e datës 04.07.2022.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se subjekti “M...” ShPK me seli në Prishtinë, këtu paditësi, përmes DUD-ave nr.R-6474/25.03.2017, R-6781/29.03.2017, R-7257/04.04.2017, R-7872/11.04.2017 dhe R-7828/11.04.2017 të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Interevropa, ka deklaruar për zhdoganim mallin lëndor, sipas dokumentacionit përcjellës të mallit. Po ashtu nuk ishte kontestuese as fakti tjetër që e paditura e ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit nga paditësi, e ku si rezultat i kësaj përmes proceseve mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, ka caktuar bazë të re doganore për këtë mall, duke u bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit nga neni 35, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr. ..., në bazë të dhënave të disponueshme . Nuk është kontestues as fakti se paditësi ka ushtruar ankesë në Doganën e Kosovës e për të cilën ankesë e paditura me datë 04.05.2017, ka sjell aktvendimin nr. 06.2/237, me të cilin ka refuzuar ankesën e këtu paditësit, tutje lidhur me këtë lëndë kjo Gjykatë duke vendosur sipas padisë së paditësit me Aktgjykimin nr. 1025/17 të datës 18.03.2020, ka aprovuar padinë e paditësit, ka anuluar aktvendimin nr. 06.2/237 të datës 04.05.2017 dhe lëndën e ka kthyer në Rishqyrtim – rivendosje, ndërsa e paditura duke vepruar sipas këtij Aktgjykimi në Rishqyrtim – rivendosje ka sjell aktvendimin nr. 06.2/237 të datës 03.12.2020, me të cilin prapë ka refuzuar ankesën e këtu paditësit e ndaj të cilin aktvendim paditësi me padinë e datës 19.01.2021 ka iniciuar prapë këtë kontest tregtar administrativ.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës ka konfirmuar vendimin me nr.06.2/237 të datës 04.05.2017 të Zyrës së Brendshme Doganore Interevropa me të cilin është refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë “M...” ShPK, këtu paditësit për rishqyrtimin e DUD-ave R-6474/25.03.2017, R-6781/29.03.2017, R-7257/04.04.2017, R-7872/11.04.2017 dhe R-7828/11.04.2017, sipas të cilit vendim ka konstatuar se Zyra e pranimit qendror ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar me qellim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDA-së, po ashtu e paditura në vendimin kontestues deklaroi se dokumentacioni përcjellës i mallrave lëndor për DUD-at kontestues tek importet e realizuara nga Emiratet e Bashkuara është i pamjaftueshëm, pasi që mungon deklarata eksportuese, andaj Zyra Doganore ka vepruar drejtë kur mallin lëndor e ka vlerësuar komfor metodës së gjashtë të vlerësimit, neni 35 të KDA-së, duke u bazuar në të dhënat e disponueshme.

Gjykata konstaton se e paditura vendimin kontestues ndonëse e ka nxjerr në ri procedurë duke vepruar në zbatim të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1025/17 datës 18.06.2020, ajo nuk i ka respektuar pikëpamjet juridike të Gjykatës, pra ka nxjerr vendim në kundërshtim me udhëzimet dhe vërejtjet e Gjykatës, duke anashkaluar kështu detyrimet ligjore nga neni 65 i LKA-së.

Gjykata vlerëson se e paditura sikurse në vendimin e parë refuzues me nr.06.2/237 të datës 04.05.2017, për rishqyrtimin e Aktvendimit nr. R-6474/25.03.2017, R-6781/29.03.2017, R-7257/04.04.2017, R-7872/11.04.2017 dhe R-7828/11.04.2017, të Zyrës së Brendshme Doganore Interevropa, ka dhënë arsyetim të njëjtë sa i përket bazës ligjore ku e paditura e ka mbështetur vendimin e kontestuar. Sipas të paditurës Dogana e Kosovës ka analizuar çmimet e mallit të deklaruar dhe ka hulumtuar për vlerën e mallit të njëjtë/ngjashëm të zhdoganuar më herët si çmimet në dosje të vlerës dhe mbi bazën e analizave të tilla ka rezultuar se vlera e deklaruar është vlerë më e ulët se vlera reale e mallit lëndor.

Për Gjykatën një konstatim i tillë është i pa qëndrueshëm dhe në kundërshtim edhe me udhëzimet e dhëna nga Gjykata kur rasti është kthyer në rivendosje. E paditura ka dështuar të veprojë sipas udhëzimit të dhënë me vendimin e Gjykatës me të cilin rasti ishte kthyer në rivendosje e ku e paditura ishte obliguar që në përputhje me autorizimet nga neni 82 paragrafi 1 të KDA-së, e obligon të paditurën që të deklarohet lidhur me faturat dhe transaksionet bankare të paditësit, për të konstatuar se faturat, transaksionet bankare dhe dokumentet përcjellëse pse nuk janë marr për bazë dhe nuk janë pranuar si valide.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit A.nr127/2021 të datës 13.06.2022 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë konflikt administrativ me ekspertin financiar Vetima Vuçitërna e cili ka pasur për detyrë të konstatojnë diferencën e mjeteve të paguara më tepër për shkak të rivlerësimit të DUD-ave kontestues R-6474/25.03.2017, R-6781/29.03.2017, R-7257/04.04.2017, R-7872/11.04.2017 dhe R-7828/11.04.2017 për secilin DUD veç e veç dhe për të gjithë së bashku, të identifikoj transaksionet bankare ndërkombëtare për çdo faturë të DUD-it kontestues, të identifikoj edhe kontratat eventuale dhe nëse të njëjtat janë të harmonizuara me faturat e DUD-ave kontestues me transaksionet bankare ndërkombëtare dhe fakte tjera të rëndësishme për vendosjen e kësaj çështje juridike administrative. Ekspertja financiare në ekspertizën e datës 04.07.2022 ka konstatuar se pas analizimit të të gjithë dokumentacioneve në dispozicion konstaton se vlera e përgjithshme e obligimeve për pagesë si rezultat i rivlerësimit doganor është 25,262.67€. Të gjitha faturat e prezantuara si pjesë e dokumentacionit doganor për DUD-at kontestues, pala paditëse i ka paguar përmes transaksioneve bankare. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor ekspertja financiare deklaroi se ekspertizën financiare e ka hartuar konform aktvendimit të gjykatës, sipas detyrave të përcaktuara në aktvendimin, kështu që në mënyrë analitike ka sqaruar dhe dhënë mendim dhe konstatim të ekspertit për çdo detyrë veç e veç. Andaj, qëndron pranë ekspertizës financiare të hartuar të datës 04.07.2022, si dhe mendimit dhe konstatimit të ekspertit në faqen 7-të të ekspertizës. Një sqarim i cili është dhënë në ekspertizë, sa i përket transaksioneve se është dhënë shumë totale për disa DUD-a, të cilat janë sqaruar në faqen 6 dhe 7 të ekspertizës financiare.

Lidhur me parashtresën e palës së paditur të datës 18.10.2022, e në pjesën ku e ka kundërshtuar ekspertizën financiare lidhur me transferet, sqaroj se në ekspertizën financiare nga faqja 4 deri në faqen 7 janë të dhëna transferet, përveç elementeve tjera të paraqitura për DUD-at kontestues dhe jo kontestues, të njëjtat janë të harmonizuara në kuptim të vlerës dhe përshkrimit-referencës së pagesës.

Gjykata e mori në tërësi si të bazuar dhe ia dha besimin e plotë ekspertizës së lartpërmendur, ngase ekspertiza i përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale, dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoj si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë konflikt administrativ, si dhe e njëjta është në harmoni me legjislacionin doganor të aplikueshëm.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, përmes DUD-ave nr. R-6474/25.03.2017, R-6781/29.03.2017, R-7257/04.04.2017, R-7872/11.04.2017 dhe R-7828/11.04.2017 të Zyrës së Brendshme Doganore në Interevropa dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 25,262.67€, mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata konsideron se paditura do të mund ta mbështetet një konstatim të këtillë vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor kontestues, i ka paguar eksportuesit mbi çmimin neto të faturave të mallit, ku vlera e mallit të faturuar nga eksportuesi është paguar nga paditësi përmes transaksioneve bankare si në vijim fatura nr. ... të datës 21.03.2017 për DUD-in R-6781 është paguar përmes transferit bankar të datës 10.07.2017 të realizuar në bankën TEB në të cilin transfer është bërë pagesa e faturave edhe për tre DUD-a jokontestues R-5520, R-4960 dhe R-6168, e cila pagesë është në harmoni të plotë me vlerën dhe përshkrimin e

faturave, fatura nr.2017-03 e datës 07.03.2017 për DUD-in R-7827/11.04.2012 dhe fatura nr.2017-03 e datës 25.02.2017 për DUD-in R-6474/25.03.2017 është paguar përmes transferit bankar të datës 03.05.2018 të realizuar në bankën TEB, në të cilin është bërë pagesa edhe për një DUD tjetër jokontestues R-4872, e që është në harmoni të plotë me vlerën dhe përshkrimin e faturave, fatura nr.0000000382 e datës 03.04.2018 për DUD-in kontestues R-7257/04.04.2017 dhe fatura nr.0000000384 e datës 10.04.2017 për DUD-in kontestues R-7828/11.04.2017 është bërë përmes transferit bankar të datës 09.08.2017, së bashku me vlerën e dy DUD-ave jokontestues R-8515 dhe R-9174, e që është në harmoni të plotë me vlerën dhe përshkrimin.

Gjykata vlerëson se nuk përbën shkak ligjor për rivlerësim të mallit dhe caktim të bazës së re doganore për paditësin, fakti që e paditura disponon me të dhëna nga dosja e vlerës, në bazë të të cilës vlera e mallit është dukshëm më e lartë se vlera e deklaruar nga subjekti, sepse me dispozitën ligjore të nenit 31 par.1 të KDAK-së nuk thuhet që vlera doganore e mallrave të importuar duhet të jetë e njëjtë me vlerën e mallrave të marra nga Dosja e Vlerës, por aty përkundrazi shprehimisht përcaktohet se *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”*. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së është parashikuar që *“Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”*.

Sipas nenit 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, është parashikuar që, dokumenti që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*.

Në interpretim të drejtë të dispozitave ligjore të cituara, Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka paraqitur faturat e mallit lëndor me nr.0000000375 të datës 21.03.2017 e cila është paguar me transferin e datës 10.07.2017 në bankën TEB, faturën 2017-03 të datës 07.03.2017 dhe 2017-02 të datës 25.02.2017 të cilat janë paguar më transferin bankar të datës 03.05.2018 në bankën TEB, faturat 0000000382 e datës 03.04.2017 dhe 0000000384 e datës 10.04.2017 të cilat janë paguar me transferin e datës 09.08.2017 në bankën TEB, kontratat e datës 25.07.2013 dhe deklaratat eksportuese EXA. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Arsyetimi i të paditurës i dhënë në vendimi e kontestuar se në shkresat e lëndës ka munguar deklarata eksportuese prandaj Dogana e Kosovës e ka të pamundur të pranoj vlerën e transaksionit të subjektit në procedurë, për Gjykatën nuk është i bazuar, sepse me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109 dhe as me dispozitat e UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave, nuk parashihet që deklarata eksportuese është dokument i cili duhet bashkangjitur deklaratës doganore, për vendosje në qarkullim të lirë të mallit të importuar dhe për tu aplikuar metoda e parë e vlerësimit sipas nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Prandaj nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata përfundimisht cilëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, komfor nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109. Nisur nga kjo, gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 292 pika b, të KDAK-së nr.03/L-109, nenit 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, miratoj kërkesëpadinë e paditësit, e anuloj vendimin e kontestuar të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t'i kthej shumën prej 25,252.67€, të paguar më tepër për shkak të rivlerësimit të pa drejtë mallit, në emër të detyrimeve importuese, për mallin e zhdoganuar

përmes DUD-ave me nr. R-6474/25.03.2017, R-6781/29.03.2017, R-7257/04.04.2017, R-7872/11.04.2017 dhe R-7828/11.04.2017 të Zyrës së Brendshme Doganore Interevropa.

Gjykata konstaton se shuma e paguar më tepër nga paditësi në emër të detyrimeve doganore, si pasoj e vlerësimit të mallit nga e paditura u kontestua nga ekspertiza financiare e datës 04.07.2022 e ekspertes V.V, e cila shumë nuk u kontestua nga pala e paditur dhe u pranua si e tillë.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë/Departamenti Fiskal

KF.nr.227/22, datë 24.10.2022

Bashkëpunëtori Profesional
Visar Gashi

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.